



Nr. 263 Prot

Tiranë, më 22/7/2024

**Procedurat e Pranimit për Kandidatët nga Republika e Kosovës dhe Kandidatët me Përkatësi Etnike Shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci në Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë,  
Viti Akademik. 2024-2025.**

Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ofron programet e studimit "Bachelor" në *Fizioterapi* dhe *Infermieristikë*, *Ekonomi Ndërmarrjeje* dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në *Odontoiatri dhe Proteza Dentare*, *Farmacit* dhe *Arkitekturë*. Programet e studimit zhvillohen në gjuhën italiane.

**I. Kuotat e disponueshme dhe kriteret e pranimit**

Tabela e kuotave të disponueshme për pranim në programet e studimit të ofruara në ciklin e parë dhe të dytë për kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci:

Programi i Studimit	Kuota të disponueshme
Ekonomi Ndërmarrjeje	5
Infermieristikë	2
Fizioterapi	4
Odontoiatri dhe Protezë Dentare	2
Farmacit	2
Arkitekturë	5

Për të dorëzuar aplikimin për pranim, kandidatët duhet të kenë përfunduar shkollën e mesme dhe të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të kenë diplomën e arsimit të mesëm;
- të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.436, i datës 03.06.2020, i Republikës së Shqipërisë, për vitin akademik 2024-2025, sipas së cilit nota mesatare e shkollës së mesme **duhet të jetë e barabartë ose më e lartë se 6.5** (referuar sistemit arsimor shqiptar);
- mos të jenë të regjistruar në të njëjtën kohë në programe të tjera studimi në të njëjtin vit akademik, pranë universiteteve publike dhe/ose private, shqiptare dhe/ose të huaja.



**UNIVERSITETI KATOLIK  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**

- duhet të kenë kryer procedurën e Njehsimit të Diplomës së Maturës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore të Republikës së Shqipërisë brenda muajit 30 mars 2025.
- Përzgjedhja e kandidatëve në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë për degët *Fizioterapi, Infermieristikë dhe Odontoiatri dhe Proteza Dentare*, bëhet nëpërmjet testeve të pranimit, të cilat përfshijnë:

1. Testim me shkrim në Italisht, mbi njohuritë në Shkencat Natyrore (bazuar në lëndët si Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim me shkrim mbi njohuritë në Gjuhën Italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
	<b>80 pikë</b>

Testimet e pranimit do të zhvillohen në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri, në datat e mëposhtme:

Program i studimit	Data	Ora
Program i integruar i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	<b>16.09.2024</b>	<b>12:00</b>
Program i studimit "Bachelor" në <i>Fizioterapi</i>	<b>16.09.2024</b>	<b>15:00</b>
Program i studimit "Bachelor" në <i>Infermieristikë</i>	<b>16.09.2024</b>	<b>15:00</b>
Program i integruar i studimit të ciklit të dytë Arkitekturë	<b>16.09.2024</b>	<b>11:00</b>

- **Për Programin e Studimit të Arkitekturës**, përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes kriterëve të mëposhtme:

- Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nëpërmjet kriterëve të mëposhtme:

1. Testim me shkrim, në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë e kulturës së përgjithshme të zotëruar nga kandidati.	30 pikë
2. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
<b>Total</b>	<b>60 pikë</b>

- **Për Programet e Studimit të Ekonomi Ndërmarrjeje dhe Farmaci nuk parashikohet test pranimi.** Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes vlerësimit të Notës Mesatare të kurrikulës mësimore të Shkollës së Mesme.

**II. Për të dorëzuar aplikimin për pranim, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:**





## **II. Për të dorëzuar aplikimin për pranim, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:**

Për t'u regjistruar dhe marrë pjesë në testet e pranimit për programet e *Odontoiatri dhe Protezë Dentare, Fizioterapi, Infermieristikë dhe Arkitekturë, Farmaci dhe Ekonomi Ndërmarrjeje* nga data **02 - 13 shtator 2024**, ora **23.59**, bëhet regjistrimi *online* në portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>, duke bashkangjitur një kopje elektronike në formatin PDF (skanim pdf/A) i dokumentacionit të mëposhtëm:

1. Kopje e dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton njehsimin e diplomës së shkollës së mesme, shoqëruar me kopjen e diplomës/certifikatës dhe listën e notave. Kandidatët që nuk kanë mbyllur procesin e njohjes dhe njehsimit dorëzojnë certifikatën e lëshuar nga QSHA në momentin e dorëzimit të aplikimit.
2. Kopje e noterizuar në Republikën e Shqipërisë (e përkthyer në shqip nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), dhe e Diplomës së maturës Shtetërore dhe e certifikatës së notave, ose Diplomës/Certifikatës së shkollës së mesme të marrë në vendin përkatës, me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet kompetente vendore ose qendrore të vendit në të cilin janë kryer studimet.
3. Dokument identifikimi.

Për të marrë pjesë në testin e pranimit, nga **data 02 shtator deri më 13 shtator 2024 në orën 16:30**, kandidatët duhet:

1. të dërgojnë një kopje të kartës së identitetit me email në adresën [info@unizkm.al](mailto:info@unizkm.al) duke specifikuar atësinë dhe numrin tuaj të telefonit;
2. të paguajnë tarifën e testit të pranimit prej 2000 lekë në mënyrat e mëposhtme:
  - në degët e Banca Intesa Sanpaolo në llogarinë rrjedhëse[1] me të dhënat e mëposhtme:  
Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)
    1. IBAN AL60208112040000030694935302 për pagesat në Euro;
    2. IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.
  - me kartë krediti online në portalin e universitetit në adresën elektronike: <http://admissions.unizkm.al/>;
  - duke paguar *cash* pranë Zyrës së Pranimeve të Studentëve të Universitetit, e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00 deri në 16:30.

Duke pasur parasysh numrin e caktuar të kuotave të disponueshme për këtë kategori, kandidatët do t'i nënshtrohen një testi përzgjedhës më **datë 16 shtator 2024** në bazë të Programit të Studimit për të cilin kanë aplikuar.

Pjesëmarrësit në testet e pranimit duhet të paraqiten pranë Sekretarisë Mësimore të paktën 30 minuta para fillimit të testit përkatës me një dokument identifikimi (kartë Identiteti/pasaportë). Ndalohet futja dhe marrja me vete e mjeteve të komunikimit elektronik (celular, iPhone, iPad, etj.)



gjatë testimit. Pjesëmarrësit që posedojnë një ose më shumë prej tyre do të përjashtohen menjëherë nga procedura e konkurrimit.

Renditja do të bëhet në bazë të rezultateve përfundimtare individuale, sipas rendit zbritës të pikëve të marra dhe do të publikohen në Universitet dhe në faqen zyrtare [www.unizkm.al](http://www.unizkm.al) më datë **18 shtator 2024**.

### **III. Regjistrimi/ Matrikullimi**

Sipas Dekretit të Ministrisë n.12 të datës 30.06.2023 të Ministrisë shqiptare të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në përputhje me Dekretin e Përbashkët nr. 112, dt. 05.07.2024, kandidatët nga Republika e Kosovës dhe kandidatët e përkatësisë etnike shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, **mund të regjistrohen në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në periudhën midis 26 shtator deri në 03 tetor 2024**. Kuotat e mbetura bosh mund të plotësohen deri ne dt. 10 tetor.

**Për arsye të regjistrimit, krahas dokumenteve të dorëzuara në momentin e regjistrimit personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi me prokurë, kandidatët e shpallur fitues të testeve të pranimit duhet të paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Faturën e pagesës bankare të këstit të parë ose të gjithë tarifës vjetore (fletë që shkarkohet nga portali studentor: [portal.unizkm.al](http://portal.unizkm.al), zëri: "Tarifat");
- Formularin e paraqitjes së aplikimit i referuar në Shtojcën nr.2, pjesë përbërëse e këtij Dekreti.
- Deklaratën bashkëlidhur këtij Dekreti (Shtojca nr. 1)
- Dy fotografi;

**Dokumentet në pikën 2 të këtij artikulli duhet të jenë të vërtetuara me vulën Apostile të vendit të origjinës.**

**Kandidatët që nuk janë në rregull me dorëzimin e dokumenteve të përmendura do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të mund t'i nënshtrohen provimeve derisa të disponohet dokumentacioni i kërkuar.**

Regjistrimi me rezervë do të thotë se mos përmbushja e kërkesave brenda afateve të përcaktuara nga dekretet ministrore mund të rezultojë në mos marrjen e statusit të studentit dhe për rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik. **Regjistrimi në vitin e parë të programit i kandidatëve të shpallur fitues, konsiderohet me rezerve deri në marrjen e matrikullës nga QSHA.**



**UNIVERSITETI KATOLIK**  
**ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**

---

Rektori

Prof. Leonardo Palombi



---

[1] Ju lutemi specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin(et) për të cilin po kryeni pagesën. Në ditën e testimit është e nevojshme të paraqitet një kopje e urdhërpagesës pasi koha e akreditimit është e kufizuar.